



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Berat, më 14.01.2025

PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT:

“Blerje Materiale Asfalti”

I mbajtur sot, më datë ____ .01.2025, nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje Materiale Asfalti”**, me afat nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri në 6 Muaj, me fond limit prej **99,996,100.00 (Nëntëdhjetë e nëntë Milion e Nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind)**, lek pa t.v.sh.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombetare euro sipas kursit të Bankës së Shqiperisë me dt 14.01.2025 është (1.018.082) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqiperisë për monedhën euro në datë 14.01.2025 eshte 98.22 lek .

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: **“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.**

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në zbatim të neneve të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me një familje mallrash homogjene, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte furnizimin e kërkuar dhe vononte realizimin e procedurës së prokurimit dhe kjo nga ana jonë si AK do përkthehej në vonesa lidhur me shërbimet tona në terren duke pasur parasysh nr e madh të kërkesave nga ana e Komunitetit lidhur mbi mirëmbajtjen e rrugeve etj . Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Së dyti theksojmë se kjo është një procedurë e cila realizohet në mënyrë të përvitshme nga Autoriteti Kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, dhe për vetë rëndësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi në lidhje me mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore qoftë atyre ekzistuese por edhe të reja, si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash, ndër vite është realizuar e përqendruar në një kontratë.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rëndësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash homogjene gjykojmë se realizimi i saj në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT